

## Dispozita e pacientit SRK

Në mënyrë që vullneti juaj të mund të përmbushet.



Croix-Rouge suisse  
Schweizerisches Rotes Kreuz  
Croce Rossa Svizzera





## Përse pikërisht një dispozitë për pacientin?

Të jetosh do të thotë edhe të shijosh lirinë e të qenurit në lëvizje, duke marrë parasysh rreziqe të ndryshme, pa marrë gjithmonë në konsideratë më të keqen. E megjithatë ia vlen të jeni të përgatitur mirë për një rastin të tillë. Në rast të një sëmundjeje të rast rëndë ose pas një aksidenti ka të ngjarë të mos jeni më në gjendje të vendosni vetë rreth masave mjekësore që duhen marrë për ju, të lajmëroni të afërmit tuaj apo të ndërmerri hapa të tjerë. Falë dispozitës së pacientit të Kryqit të Kuq Zvicëran (SRK) juve ju jepet mundësia e përcaktimit qartazi të dëshirave dhe të pritshmërive tuaja duke qënë të sigurt, që vullneti juaj do të respektohet edhe në rastin kur ju nuk jeni më në gjendje ta shprehni vetë atë. Në varësi të rrethanave mund të zgjidhni versionin kompakt

apo atë të detajuar të dispozitës së pacientit SRK.

### **Përkujdesuni me kohë – nuk është kurrë tepër herët!**

Në këtë mënyrë u hiqet një barrë të madhe edhe të afërmeve, në mënyrë që ata në rastin e një sëmundjeje të rëndë ose të një aksidenti të jenë në gjendje të njohin qartazi dhe të vënë në jetë sa më mirë që të jetë e mundur dëshirat e të afërmit të tyre në fjalë.

Por me dispozitën në fjalë u vihet shumë në ndihmë edhe mjekëve e mjekëve, duke i vënë në dijeni mbi mënyrën në të cilën personi i prekur mendon rreth sëmundjes, rreth jetës dhe vdekjes së tij. Dispozita e pacientit u lehtëson atyre marrjen e vendimeve të vështira.

## Dispozita e pacientit SRK – përmbledhje e pikave kryesore

Nëse dëshironi, këshilltarët e SRK-së janë të gatshëm t'ju ndihmojnë për hartimin e dispozitës suaj personale të pacientit SRK.

Dispozita e pacientit SRK ju jep mundësinë të përcaktoni dhe shprehni qartazi vlerat dhe dëshirat tuaja personale duke bërë të mundur që vullneti juaj të respektohet edhe në rastin kur ju ndoshta nuk do të mund të jeni në gjendje ta shprehni vetë.

Dispozita juaj e pacientit SRK u lehtëson të afërmeve tuaj dhe mjekëve dhe mjekëve marrjen e vendimeve të vështira.

Vini në dijeni persona të përcaktuar prej jush (përfaqësuesin tuaj të autorizuar, mjekun e familjes, fëmijët etj.) për ekzistencën e dispozitës suaj të pacientit SRK.

Mbani gjithmonë me vete dokumentin tuaj personal identifikues, i cili përmban të dhëna edhe mbi ekzistencën e dispozitës suaj të pacientit SRK.

Dispozita juaj e pacientit SRK është e vlefshme nëse si data, ashtu dhe nënshkrimi janë bërë me dorë. Kontrolloni dispozitën tuaj të pacientit SRK të paktën çdo dy vjet ose atëherë kur gjendja juaj shëndetësore ose rrethanat e jetës pësojnë ndryshim. Vërtetoni përditësimin e dokumentit në fjalë gjithmonë duke shënuar datën dhe duke e nënshkruar.

Dispozita juaj e pacientit SRK përdoret vetëm në rast paaftësie gjykimimi nga ana juaj, në kuadrin e së cilës ju nuk jeni në gjendje të shprehni vetë vullnetin tuaj.

Ju mund të zgjidhni midis një versioni kompakt apo një versioni të detajuar të dispozitës të pacientit SRK.



**A dëshironi një këshillim?  
Na telefononi!  
Tel.: 0800 99 88 44**

Ju mbështesim me kënaqësi gjatë hartimit të dispozitës suaj të pacientit SRK.



## Dispozita e pacientit SRK – një ofertë e gjithanshme

### **Këshillimi**

Hartimi i dispozitës së pacientit SRK cek çështje të shumta ekzistenciale dhe etike. Të përfytyrosh sot se ç'mund të ndodhë në një të nesërme është më e lehtë në kuadrin e një bisede. Mos hezitoni të na kontaktoni. Këshilltarët dhe këshilltarët tanë kompetentë zotërojnë njohuritë e nevojshme mjekësore dhe përkujdesimore dhe janë në gjendje t'ju vijnë në ndihmë për hartimin e dispozitës suaj të pacientit. Së bashku me ju ata do të qartësojnë dëshirat dhe pritshmëritë tuaja. Këshilluesit i nënshtrohen detyrimit të mosfoljes me të tretët.

### **Depozitimi**

Ju mund të na dërgoni dispozitën tuaj të pacientit SRK të plotësuar, të datuar

dhe të nënshkruar për depozitim.

Dokumenti në fjalë regjistrohet në mënyrë elektronike dhe ruhet në Vendin e Depozitimit SRK. Përparësia e ruajtjes së dispozitës pranë Vendit të Depozitimit qëndron në faktin që ajo në rast urgjence mund të gjendet shpejt dhe t'i përcillet personelit mjekësor përkatës – dhe kjo për 365 ditë në vit dhe 24 orë në ditë.

Si këshillimi ashtu dhe depozitimi janë me pagesë.

### **Shqyrtimi**

Një person i specializuar e shqyrton dispozitën tuaj të pacientit SRK para pranimit për depozitim në lidhje me përmbajtjen, me vlefshmërinë formale dhe me kuptueshmërinë.

Do të lidhemi me ju nëse do të na duken të nevojshme përshtatje të tekstit të dispozitës.

### **Dokumenti identifikues**

Do t'ju lëshohet një dokument vetjak identifikues, i cili dëshmon praninë e dispozitës suaj të pacientit SRK. Dokumenti identifikues përmban numrin e telefonit të Vendit të Depozitimit SRK, me anë të të cilit personat e autorizuar mund të kërkojnë dispozitën tuaj të pacientit. Jepuni personave të përzgjedhur prej jush (përfaqësuesit tuaj të autorizuar, mjekut të familjes, fëmijëve etj.) një kopje të dispozitës suaj të pacientit SRK.

### **Aktualizimi**

Në mënyrë periodike ne do t'ju lajmërojmë duke ju kujtuar të aktualizoni dispozitën tuaj të pacientit SRK. Pavarësisht kësaj ju mund ta ndryshoni ose ta anuloni dispozitën në çdo kohë.

### **Përcjellja**

Dispozita e pacientit mund t'i përcillet më tej vetëm personave të autorizuar me specializim mjekësor. Vendi i Depozitimit SRK verifikon identitetin e personave në fjalë para përcjelljes së dispozitës. Konfidencialiteti dhe tutelimi i të dhënave personale janë të garantuara.



## Dispozita e pacientit SRK – pikat thelbësore

Dispozita e pacientit SRK përbën një dokument në të cilën është fiksuar me shkrim lloji i trajtimit mjekësor që ju parapëlqeni ose refuzoni në rast paaftësie për të marrë vendim nga ana juaj. Dispozita e pacientit SRK u hartua nga specialistë për mjekësi, për çështje juridike etike dhe përputhet me ligjet në fuqi. Sipas të drejtës së re të mbrojtjes së të rriturve, e cila është në fuqi që nga fillimi i vitit 2013, mjekët dhe mjekët janë të detyruar të sigurohen paraprakisht mbi praninë e një dispozite pacientësh në rast paaftësie gjykim. Ata janë të detyruar të veprojnë në përputhje të plotë me dispozitën.

Dispozita juaj e pacientit SRK është e vlefshme në qofte se në të si data ashtu dhe nënshkrimi janë kryer me dorë.

### **Rreth përmbajtjes**

Në dispozitën e pacientit SRK ju vendosni mbi trajtimin e dhimbjeve dhe të simptomave të tjera, mbi mënyrën e marrjes së ushqimit dhe të lëngjeve, mbi masat e tjera për zgjatjen e jetës si dhe për reanimimin. Veç bërjes të njohur të botëkuptimit tuaj, në dispozitën në fjalë mund të përcaktoni personin përfaqësues të autorizuar prej jush si dhe të bëni të njohur praninë e dokumentave të tjerë në formë të shkruar mbi forma të parakujdesjes.

### **Çështje formale**

Dispozita e pacientit SRK duhet të përmbushë kriteret formale: Duhet të përmbajë mbiemrin, emrin, datëlindjen, vendbanimin dhe numrin e sigurimit shoqëror apo numrin AHV. Dispozita duhet të jetë e lexueshme në mënyrë të qartë. Data dhe nënshkrimi i dispozitës së pacientit SRK duhet të 'i vihen me dorë.

### **Vlefshmëria**

Vlefshmëria juridike e dispozitës së pacientit nuk është e kufizuar me afat. Megjithatë, rekomandohet që vlefshmëria kohore të verifikohet rregullisht dhe t'i përshtatet rrethanave të reja. Aktualizoni dispozitën

tuaj të pacientit të paktën çdo dy vjet ose atëherë, kur gjendja juaj shëndetësore ose rrethanat e jetës pësojnë ndryshim.

### **Personi përfaqësues i autorizuar prej jush**

Në dispozitën e pacientit SRK ju përcaktoni personat, në të cilët keni besim dhe të cilët në përputhje me dëshirën tuaj do të përfshihen në procesin e vendimmarrjes, në qoftë se ju nuk jeni më të aftë të merrni vendim.

**Ju këshillojmë me kënaqësi.  
Schweizerisches Rotes Kreuz  
(Kryqi i Kuq Zviceran)**

Werkstrasse 18  
3084 Wabern

Numri i telefonit: 0800 99 88 44 (falas)  
Nga e hëna deri të premten,  
nga ora 8 deri në orën 12  
info@redcross.ch  
www.redcross.ch

Ofertat tona:

**redcross-edu.ch**

Njohuri për jetën

**pfllege-entlastung.ch**

Pauzë nga jeta e përditshme

**Numri urgjent i Kryqit të Kuq**

Siguri 24-orëshe

**Shoqërim me automjetin e Kryqit të Kuq**

Lëvizshmëri - edhe në moshë të thyer apo gjatë sëmundjes

**Dispozita e pacientit SRK**

Në mënyrë që vullneti juaj të mund të përmbushet.

**Përkujdesje shtëpiake për fëmijët**

Spirancë shpëtimi për prindër në vështirësi

**Pasazh SRK**

Përkujdesje për personat me sëmundje të rënda  
apo që janë duke vdekur

**Trajnim "chili"**

I fortë në konflikt

Të gjitha informacionet e nevojshme gjenden  
në faqen:

**www.redcross.ch**



**Croix-Rouge suisse  
Schweizerisches Rotes Kreuz  
Croce Rossa Svizzera**

